



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8 Mars 2023

Nr: 101

Ora: 11:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONAVE PËRGJEGJËS, PËR RAPORTIMIN E
VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
14 MAJ 2023**

Sot më datë 8 Mars 2023, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

- SUBJEKTE:**
- Z. Gazmend Turdiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - Zj. Emerlinda Pema, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për Ministrinë e Shtetit për Standartet dhe Shërbimet;
 - Z. Florenc Doka, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Cërrik;
 - Zj. Arta Shaha, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Tepelenë;
 - Zj. Laura Brinja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Vlorë;
 - Z. Elton Sula, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Rrogozhinë;
 - Z. Xhelil Tusuni, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Libohovë;
 - Z. Ditmir Kraja, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Shkodër;
 - Zj. Urieta Lumi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Dibër;
 - Z. Mustafa Çarçiu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Belsh.

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka marrë indicie për organizimin e 16 (gjashtëmbëdhjetë) veprimtarive publike, nga 10 (njëmbëdhjetë) institucione publike, për të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar për këtë qëllim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Indiciet janë marrë nëpërmjet provave link, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, u shqyrtua paraprakisht çështja dhe vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për t’u nisur hetimi administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundravajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë paraqitur 16 (gjashtëmbëdhjetë) indicia, nëpërmjet provave link të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vendos shqyrtimin së bashku të këtyre indicieve.

Në vijim të procedurës administrative, u fillua hetimi administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike të raportuar në ndërfaqe.

Data: 8 Mars 2023

Nr: 101
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike”

Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve, nga institucionet publike nëpërmjet adresës së postës elektronike email.

Subjektet objekt i këtij vendimi kanë paraqitur pretendime e tyre si më poshtë vijon:

- 1. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike për të cilën pretendohet si vijon: *“Sot në MEPJ, me disa nga studentët e qendrës rinore H.A.N.A. Diskutim i vlefshëm mbi rrugëtimin e Shqipërisë AL drejt BE EU, stadi aktual të negociatave dhe rolit që rinia ka në këtë "udhëtim" që sapo kemi nisur”.*

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=514071007533042&set=pcb.51407122419968>
Z

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator. Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 1 (një) media publike.”

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nëpërmjet email-it të datës 17.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Aktiviteti i organizuar në MEPJ më datë 19 Janar 2023, ora 10:00, me të rinjtë e Qendrës H.A.N.A në Lezhë, është organizuar si takim fundor, i cili përmbyll ciklin e trajnimit që kjo Qendër të rinjsh ka marrë nga Ministria e Jashtme e Luksemburgut për çështje të diplomacisë dhe integritetit Evropian... Aktiviteti i dt. 19 janar 2023, nuk është mediatizuar nga MEPJ dhe nuk i është përcjellë asnjë medie televizive, radiofonike apo të shkruar...”.*

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 1 Mars 2023. Gjatë seancës, përfaqësuesi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, deklaroi ndër të tjera se institucioni, gjatë periudhës kur është zhvilluar aktiviteti nuk ka qenë i pajisur me kredencialet për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, veprimtaria publike e kryer nga subjekti nuk përbën veprimtari publike të ndaluar dhe për rrjedhojë, nuk kemi përdorim të burimeve publike, në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Gjithashtu, pas njohjes me rrethanat dhe faktet, vlerësohet se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

2. Ministri i Shtetit për Standartet e Shërbimeve, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon: *“Sipërmarja, Standartet dhe Shërbimet. Arritje, sfida.”*

Link: <https://www.facebook.com/edona.bilali/videos/1560576994410181/>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 3 (tre) media publike.”

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nëpërmjet email-it të datës 20.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Takimi është organizuar ditën e enjte datë 19.1.2023, ora 11:00 në ambientet e COD në Kryeministri. Ky takim u zhvillua në vijimësi të raportimit të punëve të kryera për vitin 2022 dhe sfidat për 2023 nga të gjitha Ministrinë. Theksojmë se tematika e takimit ishte raportim mbi punët që lidhen me fushën e përgjegjësisë së Ministrisë të Shtetit për Standartet e Shërbimeve...”*

Në vijim të hetimit administrativ u njoftua përfaqësuesi i Ministrit të Shtetit për Standartet e Shërbimeve për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 1 Mars 2023. Gjatë seancës, përfaqësuesi i Ministrit të Shtetit për Standartet e Shërbimeve, deklaroi ndër të tjera se institucioni, gjatë periudhës kur është zhvilluar aktiviteti nuk ka qenë i pajisur me kredencialet për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, veprimtaria publike e kryer nga subjekti nuk përbën veprimtari publike të ndaluar dhe për rrjedhojë, nuk kemi përdorim të burimeve publike, në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Gjithashtu, pas njohjes me rrethanat dhe faktet, vlerësohet se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

3. Bashkia Cërrik, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon: *“Takim me të rinjtë e Këshillit Vendor Rinor, për të diskutuar bashkë për bashkinë e së ardhmes”.*

Link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=613540220782353&set=pcb.613540334115675>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Cërrik, nëpërmjet email-it të datës 24.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Aktiviteti i kryer nuk është publik, nuk ka pasur pjesëmarrjen e mediave dhe nuk ka pasur në agjenden e vet informimin”*.

Në vijim të hetimit administrativ përfaqësuesi i bashkisë Cërrik, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike dëgjimore të datës 1 Mars 2023, por nuk u paraqit.

Pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se organi publik, nisur nga tematika dhe natyra e veprimtarisë, ka pasur paqartësi në lidhje me karakterin publik të aktivitetit të kryer.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh faktin se aktiviteti i kryer nuk përbën veprimrimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i terheq vëmendjen përsonit të ngarkuar me detyra sipas ligjit, zbatimin e parashikimeve ligjore në lidhje me raportimin e veprimtarive publike.

- 4. Bashkia Tepelenë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon: *“Dhënie e titullit “Qytetare Nderi e Tepelenës” për poeten Zhaneta Barxhaj”*.

Link:

<https://www.facebook.com/bashkiatepelene/videos/520165913588323>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 1 (një) media publike.”

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Tepelenë, nëpërmjet email-it të datës 17.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Ceremonia është zhvilluar në datë 21.01.2023, ora 10:00 në zyrën e Kryetarit të Bashkisë Tepelene, në praninë e Media RTSH Gjirokastra”*.

Pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se organi publik, nisur nga tematika dhe natyra e veprimtarisë, ka pasur paqartësi në lidhje me karakterin publik të aktivitetit të kryer.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh faktin se aktiviteti i kryer nuk përbën veprimrimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, terheq vëmendjen përsonit të ngarkuar me detyra sipas ligjit, zbatimin e parashikimeve ligjore në lidhje me raportimin e veprimtarive publike.

- 5. Bashkia Vlorë**, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon: *“Dhenia e titullit “Mirënjohja e Qytetit” për grupin muzikor “Ricchi e Poveri”*.

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=777712277049052&set=pcb.777715187048761>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 1 (një) media publike.”

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Vlorë, nëpërmjet email-it të datës 10.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Aktiviteti nuk është vlerësuar si aktivitet me karakter publik në interpretim të nenit 92, të Kodit Zgjedhore cila”*.

Pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se organi publik, nisur nga tematika dhe natyra e veprimtarisë, ka pasur paqartësi në lidhje me karakterin publik të aktivitetit të kryer.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh faktin se aktiviteti i kryer nuk përbën veprimrimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i terheq vëmendjen personit të ngarkuar me detyra sipas ligjit, zbatimin e parashikimeve ligjore në lidhje me raportimin e veprimtarive publike.

- 6. Bashkia Libohovë,** nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon: *“Aktivitet, në nderim të dëshmorëve të Libohovës”*.

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=749899506583633&set=pcb.749899689916948>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 1 (një) media publike.”

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Libohovë, nëpërmjet email-it të datës 20.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Në këtë aktivitet morën pjesë nxënës nga shkolla 9-vjeçare "Avni Rustemi", shkolla 9-vjeçare Nepravishtë si dhe nga Gjimnazi "11-Shkurti”*.

Të pranishëm në sallë ishin familjarë të dëshmorëve, intelektual, përfaqësues nga bashkia, ish mësues, mësues dhe nxënës nga gjimnazi "11-Shkurti" si dhe shkolla 9-vjeçare "Avni Rustemi”.

Pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se organi publik, nisur nga tematika dhe natyra e veprimtarisë, ka pasur paqartësi në lidhje me karakterin publik të aktivitetit të kryer.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh faktin se aktiviteti i kryer nuk përbën veprimrimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i terheq vëmendjen personit të ngarkuar me detyra sipas ligjit, zbatimin e parashikimeve ligjore në lidhje me raportimin e veprimtarive publike.

- 7. Bashkia Rrogozhinë,** nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike, për të cilën pretendohet si vijon: *“Takim me banorët e fshatit Luz i Madh në Njësinë Administrative Lekaj, për diskutimin e problematikave”.*

Link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=516189930728778&set=pcb.516189944062110>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Rrogozhinë, nëpërmjet email-it të datës 17.2.2023, ka paraqitur pretendimet për dy veprimtaritë publike të paraportuara dhe ka sqaruar se: *“Veprimtaritë publike nuk janë raportuar për shkak të mungesës së informacionit nga ana jonë. Për veprimtaritë e tjera do jemi korrekt që të mos ketë problem të tilla”.*

Pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se organi publik, nisur nga tematika dhe natyra e veprimtarisë, ka pasur paqartësi në lidhje me karakterin publik të aktivitetit të kryer.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh faktin se aktiviteti i kryer nuk përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, tërheq vëmendjen përsonit të ngarkuar me detyra sipas ligjit, zbatimin e parashikimeve ligjore në lidhje me raportimin e veprimtarive publike.

- 8. Bashkia Shkodër,** nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 1 (një) veprimtari publike për të cilën pretendohet si vijon: *“Takim me të rinjtë e Shkodrës për të diskutuar për problematikat dhe zgjidhjet e mundshme”.*

Link:

<https://www.facebook.com/bardhspahia/videos/589033382678779/>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 2 (dy) media publike.”

Përfaqësuesi i bashkisë Shkodër ka dërguar pretendimet e tij nëpërmjet shkresës nr.2985, datë 28.2.2023, nëpërmjet së cilës pretendon se: *“Më datë 10 Shkurt 2023, ora 17:00, është zhvilluar takimi me të rinjtë dhe të rejat e Shkodrës. Ky aktivitet është organizuar nga një grup të rinj shkodranë, me pjesmarrjen e Kryetarit të bashkisë Shkodër”.*

Pasi u njoha me faktet dhe rrethanat e çështjes, vlerësoj se organi publik, nisur nga tematika dhe natyra e veprimtarisë, ka pasur paqartësi në lidhje me karakterin publik të aktivitetit të kryer.

Për sa më sipër, duke marrë parasysh faktin se aktiviteti i kryer nuk përbën veprimrimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i terheq vëmendjen përsonit të ngarkuar me detyra sipas ligjit, zbatimin e parashikimeve ligjore në lidhje me raportimin e veprimtarive publike.

9. Bashkia Dibër, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 4 (katër) veprimtari publike për të cilat pretendohet si vijon:

1. “Në Maqellarë, gjatë inspektimit të punimeve që po kryhen për sistemimin dhe rehabilitimin e plotë të trotuareve”.

Link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=188935770397115&set=pcb.188936060397086>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator”.

2. “Nga 'Muzeu i Kastriotëve' në Sinë përkujuam 555-vjetorin e vdekjes së Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu!

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=187568783867147&set=pcb.187569040533788>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator”.

3. “Me nxënësit ekselentë dhe talentet e Dibrës, së bashku me Rahim Spahiu, për ti falenderuar ata dhe të gjithë mësuesit e tyre, për punën, përpjekjet dhe kontributin që nesër të kemi qytetarë të denjë e profesionistë të zotë”.

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=560249959476342&set=pcb.560249989476339>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator.

Veprimtaria publike rezulton të jetë transmetuar në 1 (një) media publike.”

4. “Në Lishan të Epër të njësisë administrative Luzni vijoje punën intensive për rrjetin ujësjellës të këtij fshati dhe fshatrave të tjerë të zonës, si dhe për rehabilitimin e plotë të rrugës”.

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=190606166896742&set=pcb.190606326896726>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator”.

“Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Dibër , nëpërmjet email-it të datës 9.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“...Aktiviteti që përkon me vizitën e kryetarit të Bashkisë Dibër z.Rahim Spahiu në Muzeun e Sinës, në njësinë administrative Arras, më datë 17.01.2023, ora 15.00, në kuadër të 555-vjetorit të ndarjes nga jeta të heroit kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, si dhe inspektimi i punimeve për rehabilitimin e trotuareve në njësinë administrative Maqellare, ne daten 24.01.2023, ora 13.00, kanë qenë veprimtari rastësore, të paplanifikuara në axhendën javore të kryetarit, ndaj ne si persona përgjegjës kemi marrë dijeni pasi këto aktivitete janë zhvilluar.*

Nga sa më sipër, për arsye objektive nuk është bërë raportimi në ndërfaqen e KQZ-së...” “...Aktiviteti që përkon me vizitën e kryetarit të Bashkisë Dibër z.Rahim Spahiu në Fshatin Lishan, në njësinë administrative Luzni, më datë 01.02.2023, ora 15.00, për problematika në lidhje me rrjetin e Ujesjellesit ne kete fshat dhe për rehabilitimin e rruges, si dhe aktiviteti me nxenesit Ekselente te shkollave prane Hotel Veri në njësinë administrative Peshkopi, ne daten 05.02.2023, ora 16.00, kanë qenë veprimtari rastësore, të paplanifikuara në axhendën javore të kryetarit, ndaj ne si persona përgjegjës kemi marrë dijeni pasi këto aktivitete janë zhvilluar.

Në vijim të hetimit administrativ, bashkia Dibër, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike të datës 1.3.2023, ora 11:00. Ditën e seancës publike u paraqit përfaqësuesi i bashkisë Dibër, i cili shkresërisht ka deklaruar se gjatë periudhës kur është zhvilluar aktiviteti, nuk ka qenë i pajisur me kredenciale për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, veprimtaria publike e kryer nga subjekti nuk përbën veprimtari publike të ndaluar dhe për rrjedhojë, nuk kemi përdorim të burimeve publike, në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Gjithashtu, pas njohjes me rrethanat dhe faktet, vlerësohet se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

10. Bashkia Belsh, nuk ka raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 4 (katër) veprimtari publike për të cilat pretendohet si vijon:

1. *Në fshatin Marinëz, ku diskutuam për punët dhe projektet në vazhdim.*

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=629473735852673&set=pcb.629473772519336>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator”.

2. *“Bashkëbisedimi me banorët e Dumresë vijoi në fshatin Idrizaj”.*

Link:

Data: 8 Mars 2023

Nr: 101

Ora: 11:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike”

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=632210372245676&set=a.255171539949563>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator”.

3. *“Lokalitet ishte ndalesa jonë e radhës”.*

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=632756295524417&set=pcb.632756328857747>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator”.

4. *“Në lagjen Hysë ku pasi përfunduar rrjetin e ri të ujit të pijshëm, rrjetin KUZ, po punohet për sistemim asfaltimin e rrugës Belsh – Stanaj”.*

Link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=645568277576552&set=pcb.645568310909882>

Theksohet se aktiviteti nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator”.

Pas njoftimit të kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për të paraqitur pretendimet e tij, bashkia Belsh , nëpërmjet email-it të datës 14.2.2023, ka paraqitur pretendimet dhe ka sqaruar se: *“Bashkia Belsh nuk ka bërë asnjë raportim tek ndërfaqja e raportimeve të KQZ për javën 3-9 shkurt pasi akoma nuk ka filluar zyrtarisht fushata zgjedhore. Të tre linket e sjella nga ana juaj për takime që Kryetari i Bashkisë ka realizuar me banorë të fshatrave, nuk janë takime me karakter politik, por janë takime të rastësishme dhe periodike në cilësinë e kryetarit të bashkisë, për tematika të ndryshme që i referohen punëve të përditshme të Bashkisë...”*

Për sa i përket aktivitetit të fundit lagjen Hysë, më datë 22.2.2023, bashkia Belsh bën me dije se: *“Bashkia Belsh nuk ka bërë asnjë raportim tek ndërfaqja e raportimeve të KQZ për javën 13-20 shkurt pasi akoma nuk ka filluar zyrtarisht fushata zgjedhore... Linku i sjellë nga ana juaj për takime që Kryetari i Bashkisë ka realizuar me banorët e lagjes Hyse, nuk janë takime me karakter politik, por janë takime të rastësishme dhe periodike në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë për tematika të ndryshme që i referohen punëve të kryera nga Bashkia rasti konkrete janë punime të nisura me perpara dhe takimi i Kryetarit me banoret është i rastësishëm...”*

Në vijim të hetimit administrative, bashkia Belsh, u njoftua për të marrë pjesë në seancën publike të datës 1.3.2023, ora 11:00. Në seancë publike u paraqit përfaqësuesi i bashkisë Belsh, i cili ndër të tjera deklaroi se institucioni, gjatë periudhës kur është zhvilluar aktiviteti, nuk ka qenë i pajisur me kredenciale për raportim në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, veprimtaria publike e kryer nga subjekti nuk përbën veprimtari publike të ndaluar dhe për rrjedhojë, nuk kemi përdorim të burimeve publike, në mbështetje të subjekteve zgjedhore. Gjithashtu, pas njohjes me rrethanat dhe faktet, vlerësohet se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive, jashtë vullnetit të organit publik. Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objektet rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për:
 - a) Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme
 - b) Ministri i Shtetit për Standartet dhe Shërbimet
 - c) Bashkinë Prrenjas
 - d) Bashkinë Cërrik
 - e) Bashkië Tepelenë
 - f) Bashkinë Vlorë
 - g) Bashkinë Rrogozhinë
 - h) Bashkinë Libohovë
 - i) Bashkinë Shkodër

- j) Bashkinë Dibër
 - k) Bashkinë Belsh.
2. Tërheqje vëmendje për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike:
- a) Z. Gazmend Turdiu, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - b) Zj. Emerlinda Pema, Drejtor Kabineti për Ministrin e Shtetit për Standartet dhe Shërbimet
 - c) Z. Florenc Doka, Sekretar i Përgjithshëm në bashkinë Cërrik
 - d) Zj. Arta Shaha, Drejtor Drejtorie për Arsimin, Sportin, dhe Kujdesin Social në bashkinë Tepelenë
 - e) Zj. Laura Brinja, Drejtor i Burimeve Njerëzore në bashkinë Vlorë
 - f) Z. Elton Sula, Sekretar i Përgjithshëm në bashkinë Rrogozhinë
 - g) Z. Xhelil Tusuni, Nënkyetar në bashkinë Libohovë
 - h) Z. Ditmir Kraja, Këshilltar në bashkinë Shkodër
 - i) Zj. Urieta Lumi, Sekretar i Përgjithshëm në bashkinë Dibër
 - j) Z. Mustafa Çarçiu, Sekretar i Përgjithshëm në bashkinë Belsh.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI